

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. M., nga GJ., lagja “...” nr...., të cilin me autorizim e mbron avokat M. M., nga GJ., për shkak të dy veprave penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1. të KPRK-ës, dhe vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I nr.304/2016, të datës 15.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 16.03.2017, bie dhe në prezencë të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L. M., nga i ati M., dhe nëna Z., e lindur R., i lindur me datë ..., në Gj. ku edhe jeton, lagjja “...” nr. ..., ... martuar, ... punë, din shkrim dhe lexim, ka të kryer ..., i gjendjes së ... ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Se me datë2016, rreth orës ..., në Gj., në afërsi të shkollës “...”, në mënyrë të paautorizuar ka poseduar substancë narkotike dhe gjatë kontrollimit nga zyrtarët policorë, i është gjetur substancë narkotike e llojit Marihuanë, në peshë prej ... gram dhe e njëjta i është konfiskuar nga Policia e Kosovës- DHTN Gjilan .

- me çka ka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-së

II.

Se me datë ... 2016, rreth orës ..., në Gj., në oborrin e shkollës "...", vende ky ku grumbullohen nxënësit, pa leje dhe pa autorizim në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ka poseduar armën e ftohtë – një thikë e cila armë është sekuestruar nga Policia e Kosovës .

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17, 21, 46,51, 69, 73, 75, 76, 80 dhe 114 të KPRK si dhe neneve 365, 453 të KPPRK,

E G J Y K O N

Të akuzuarin L. M., për veprën penale nën dispozitivin nën I, të aktgjykimit me dënim të kushtëzuar burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro dhe për veprën penale nën dispozitivin nën II me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro. Në zbatim të dispozitave për dënimin unik i shqiptohet dënim i kushtëzuar burgu në kohëzgjatje prej 6.(gjashtë) muajve i cili dënim nuk do ta vuaj nëse i akuzuari në periudhën e verifikimit prej 1. (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht revokohet, si dhe dënimin unik me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro të cilin dënim unik me gjobë i njëjti do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit përndryshe dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim.

Të akuzuarit L. M. i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit "Marihuanë" në sasi prej ... gram, si dhe ... e sekuestruar.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro si dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.304/2016, të datës 15,12,2016, kundër të akuzuarit L. M. nga GJ., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 e nenin 281 par.1 pika 1.7 të KPK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritör sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Rabije Jakupi dhe më tej mbeti në tërësi pranë aktit akuzues të dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi sipas autorizimit i të akuzuarit L. M., avokat M. M. , deklaroi se nuk se nuk ka vërejtje në pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase pranimin e fajësisë e ka bërë edhe në konsultim me mua si mbrojtës i tij dhe shtoi se i akuzuari siç e ka deklaruar edhe në polici e edhe në prokurori se konsumimin e narkotikut të llojit mariuhan e bën nga nevoja shëndetësore sepse vuan nga veshkët dhe nga dhembjet e mëdha e njëjta i ndihmon që ta qetësojë dhe për këtë edhe e ka mbajtur substancën dhe e njëjta është gjetur tek ai, dhe se për këtë mund u sjellim edhe dëshmi por po besoi se gjykata do ta marri parasysh këtë provë.

I pandehuri L. M., deklaroi se sa i përket fajësie unë e pranoi fajësinë për këto vepra penale posedimi, i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1. dhe veprës penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, ngase të njëjtat i kam kryere këtë dhe se pranimin e fajësisë e bëjë edhe në konsultim me mbrojtësin tim avokat M. M., dhe se jam i vetëdijshëm edhe për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë dhe se këtë e bëjë vullnetarisht pa kurrfarë presioni.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: foto dokumentacioni lidhur me peshën e substancës narkotike, vërtetim mbi konfiskimin e sendeve i datës 07.12.2014 dhe raportit mbi testin fushor të substancës narkotike të datë 07.12.2016 si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari L. M. , ka kryer dy vepra penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1. të KPRK-ës ashtu që me datë2016, rreth orës ..., në Gj., në afërsi të shkollës "...", në mënyrë të paautorizuar ka poseduar substancë narkotike dhe gjatë kontrollimit nga zyrtarët policorë, i është gjetur substancë narkotike e llojit Marihuanë, në peshë prej ... gram dhe e njëjta i është konfiskuar nga Policia e Kosovës- DHTN Gjilan. Po ashtu ka kryer edhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës në atë mënyrë që me datë2016, rreth orës ..., në Gj., në oborrin e shkollës "...", vende ky ku grumbullohen nxënësit, pa leje dhe pa autorizim në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, ka poseduar armën e ftohtë – një thikë e cila armë është sekuestruar nga Policia e Kosovës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenit 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës si dhe pranimin e fajësisë e ka bërë pa hezitim dhe në mënyrë bindëse, gjithashtu i njëjti ka shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sasia e vogël e substancës si kundër edhe faktit se ky lloj i substancës paraqet një rrezikshmëri më të ulët për shëndetin e njeriut në krahasim me llojet tjera të substancave narkotike. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale. Andaj, në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese dhe mbështetur në dispozitat e neneve 75 dhe 76 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit “Marihuanë” në sasi prej ... gram, si dhe konfiskimi është bazuar në nenin 69 dhe 275 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 314 /2016 Me datë. 16.03.2017**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.